



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivery	20.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SH/00	7584/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1357/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi—anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1357/2023 të datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesit të përfaqësuar nga ankuesi me adresë Zona industriale në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmer veprimet juridike duke bërë rishqyrtimin e kërkesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë lidhur me korrigjimin, përshtatjen e koeficientëve për ankuesin në pajtim me Ligjin Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë.
- II. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën I.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesit sipas Akt Emërimeve të datës 02.12.2013 respektivisht 02.06.2014 janë të punësuar në pozitën "Veterinar" në Drejtorin e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, nga muaji shkurt deri në muajin maj 2023 sipas Ligjit Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë janë paguar më koeficient të pagës 5.1, ndërsa Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë bazuar në Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më datë 07.03.2023 ka proceduar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dokumentacionin lidhur me korrigjimin e koeficientëve përmes të cilët kanë propozuar që ankuesve t'u korrigjohet koeficienti në kuadër të shtojcës 10.6 të Ligjit Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë e që ndërlihet më pozitat Specialist me klasën I11 dhe koeficientin 7, rrjedhimisht ankuesit janë duke u paguar me këtë koeficient.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme si njësi përgjegjëse për korrigjimin përshtatjen e koeficientëve sipas Ligjit Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë, ankuesit i ka klasifikuar sipas shtojcës Nr. 9 të këtij ligji, me emërtimin Mjek Veterinar, Klasa H10 dhe koeficienti 7.4, mirëpo Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë përmes emailit të datës 29.08.2023 ka dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë tw Ministrisë së Punëve të Brendshme listën e përditësuar për ankuesit me koeficient 7 duke arsyetuar se në AUV me kualifikimin/edukimin si Mjek Veterinar të punësuar janw 60 nëpunës në pozitat Veterinar, Inspektor Veterinar, Inspektor Veterinar Kufitar, Udhëheqës i Sektorit, Udhëheqës i Zyrës Regjionale, Drejtor i Drejtorisë, duke njoftuar që klasa H10 i referohet Nëpunësve Publik të Sistemit Shëndetësor.

Duke e parë që në listën e pagave paguhen me koeficient shtatë (7), ankuesit më datë 31.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6782/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk po zbaton korrigjimin e bërë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme për klasën H10 dhe koeficientin 7.4.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.11.2023 ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa Këshilli, me datë 01.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendim me numër protokolli 7428/2023 të datës 12.13.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për 10 ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6782/2023 e datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.10.2023 nga ankuesi për ankuesin Akt Emërimin e datës 03.12.2012 të ankuesit Diplomën me N. 521 të ankuesit Diplomën të datës 12.11.2020 të

ankuesit Akt Emërimin e datës 02.6.2014 të ankueses ; Diplomën me Nr. 10318 të ankueses Vendimin Ref 6/2187 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Emailin e datës 11.10.2023 nga për ankuesit; Emailin e datës 08.09.2023 nga për Emailin e datës 01.09.2023 nga për Listën e korigjimit të koeficienteve për ankuesit; Kërkesën e datës 21.08.2023 nga ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Veterinarë; Emailin e datës 21.01.2023 nga për Emailin e datës 06.01.2023, 05.01.2023 nga për Emailin e datës 27.12.2022 nga për Emailin e datës 07.03.2023 nga për DMZP; Emailin e datës 07.03.2023 nga DMZP për përfaqësuesit e institucioneve; Emailin e datës 06.03.2023 nga për Emailin e datës 06.03.2023 nga për Emailin e datës 06.03.2023 nga për Emailin e datës 25.05.2023 nga për Emailin e datës 25.05.2023 nga për Emailin e datës 26.05.2023 nga DMZP për Emailin e datës 29.08.2023 nga për Emailin e datës 22.08.2023 nga për dhe Emailin e datës 11.01.2023 nga për ; Emailin e datës 19.09.2023, 12.10.2023 nga për ; Kërkesë për pagesë retroaktive për muajin shkurt-prill 2023 për ankuesin Listën e pagave janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor 2023 për ankuesit; Vendim me numër protokolli 7428/2023 të datës 12.13.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Kwshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të ndërmer veprimet juridike duke bërë rishqyrtimin e kërkesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë lidhur me korigjimin përshtatjen e koeficientëve për ankuesin dhe në pajtim me Ligjin Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë, sepse:

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk po zbaton korigjimin e bërë nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme për klasën H10 dhe koeficientin 7.4.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 05.02.2023, ku qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.

Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë konkretisht: neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, përcakton se: "1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit-nënkupton që secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin", neni



6 paragrafi 1, përcakton se: "1. Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji" ndërsa Neni 14 paragrafi 1, 2 dhe 3, përcaktojnë se: "1. Paga bazë e nëpunëses/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji. 2. Paga bazë e nëpunëses/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji. 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik".

Bazuar në këto dispozita, Kolegji i Këshillit, konstaton se për nëpunësit e shërbimit civil sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, aplikohet shtoja Nr.10 e këtij ligji, respektivisht mbi bazë të kësaj shtojce janë përcaktuar emërtimi i pozitës, klasa, koeficienti dhe fusha e zbatimit, respektivisht sipas provave të lëndës rezulton fakti se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 07.03.2023 përmes emailit ka kërkuar nga personat përgjegjës të Njesisë të Burimeve Njerëzore të institucioneve që të gjitha kërkesat për korrigjimeve të koeficientëve të dërgohen dhe së bashku me kërkesën të dërgohen Rregullorja për organizmin e brendshëm e institucionit, Përshkrimi i vendit të punës dhe Akt emërimi/kontrata.

Bazuar në provat materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit kanë statusin e nëpunësit civil sipas akt emërimeve dhe mbajnë pozitën "Veterinar" në Drejtorin e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa sipas Diplomave të njëjtit kanë përgatitje shkollore gjegjësisht kanë kualifikim arsimor Mjek Veterinar, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ankuesit i ka klasifikuar sipas shtojcës Nr.9 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me emërtimin "Mjek Veterinar", Klasa H10 dhe koeficient 7.4.

Duke marr parasysh që shtojca Nr.9 e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i referohet vetëm nëpunësve publik të sistemit shëndetësor, atëherë sipas kësaj rrethane Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë përmes emailit të datës 29.08.2023 ka njoftuar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme se me kualifikimin/edukimin si Mjek Veterinar janë të punësuar 60 nëpunës dhe pozitat që nëpunësit i mbajnë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk mund të klasifikohen sipas shtojcës Nr. 9, konkretisht klasës H10.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, bazuar në dispozitat ligjore të cekura si më lartë, shtojcave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe bazuar në arsyetimin si në këtë vendim, konstaton se për shkak të këtyre rrethanave është e pamundur të vendoset në mënyrë meritore lidhur me këtë çështje administrative, si rezultat i kësaj detyrohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të ndërmerret veprimet juridike duke bërë rishqyrtimin e kërkesës së Agjencisë së Ushqimit dhe

Veterinarisë lidhur me korrigjimin përshtatjen e koeficientëve për ankuesin [redacted] dhe [redacted] në pajtim me Ligjin Nr. 08/196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1357/2023, datë 20/12/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së